

Kamëz më: ____07.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Hartim Analize e Detyrës së Projektimit, Projekt-Ideja, Projekt Zbatim, Preventiv Përfundimtar, “Nërtim Qendër Shëndetësore, Kamëz”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 22114311-5 Projekte

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,094,000 (gjashtë milion e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia KAMËZ**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 10 të DST-së.

2.2 Kapciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar; nenin 43 dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata".

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur e thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

1. PROJEKTUES ARKITEKT

- a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.
- b-1. objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 3. objekte spitalore; terminalët në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.
- c- Projektim interiere.
- d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

2. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

3. PROJEKTUES INSTALATOR

- a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.
- b- Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- g- Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.
- h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.).
- i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.
- j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

4. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.

5. PROJEKTUES GJEODET

- a- Rivelime inxhinierike.

6. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.

7. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

- e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr. 759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuader të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik në Licensën e Shoqërisë stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar:

- 1 (një) Arkitekt/Urbanist

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Konstruktor/Strukturist)
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Mekanik;

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë.

Shënim: Kriteri do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te pergjithshme te references per objektet pjese e kesaj procedure, pjese e secilave do te jene te licensuar per sherbimet qe priten te realizohen.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Prania e stafit teknik per afatin e kerkuar ne listepagesa i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrueshem, operativ i cili do te kryeje sherbimin ne kohe dhe cilesi.

1 (një) Arkitekt/Urbanist: Arkitekti/urbanisti është i nevojshëm për të koordinuar të gjitha disiplinat, konceptimin hapësinor sipas flukseve mjekësore (ndarja e zonave të pastra/papisura, urgjenca, administrata, etj.). Ai kontribuon në përcaktimin e elementëve arkitektonikë të veprës, organizimin e hapësirave funksionale dhe harmonizimin e projektit me zhvillimin urbanistik të zonës.

1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Konstruktor/Strukturist): Inxhinieri i Ndërtimit me profil konstruktor është specialisti kryesor për projektimin strukturor të objektit. Ai bën llogaritjen

strukture e godinës 3-katëshe, analizat sizmike (shumë e rëndësishme për objekte të rëndësishme si lartë si qendrat shëndetësore. Ai realizon analizat statike dhe dinamike të strukturës, dimensionimin e elementëve mbajtës, si dhe përcaktimin e materialeve dhe detajeve konstruktive që garantojnë qëndrueshmërinë dhe sigurinë e veprës.

1 (një) Inxhinier Hidroteknik: Inxhinieri Hidroteknik është i nevojshëm për realizimin e projektit të rrjetit të furnizimit me ujë (përfshirë depot rezervë dhe sistemet e pompimit), rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale/spitalore, si dhe mbrojtja nga zjarri (sistemi hidrant)

1 (një) Inxhinier Elektrik: Inxhinieri Elektrik është i nevojshëm për realizimin e projektit të rrjetit të furnizimit me energji, rrjeti i ndriçimit emergjent, linjat e dedikuara për pajisjet mjekësore, tokëzimi, mbrojtja rrufepritëse, rrjetet e reja kompjuterike (LAN), sistemi i thirrjes së infermierit dhe kamerat e sigurisë.

1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Makshajder: Inxhinieri Gjeodet.. është i nevojshëm për realizimin e matjeve topografike dhe gjeodezike të terrenit, për përgatitjen e hartave topografike dhe për përcaktimin e saktë të koordinatave dhe kuotave të elementëve të projektit, të cilat përbëjnë bazën për hartimin korrekt të projektit të zbatimit.

1 (një) Inxhinier Gjeolog: Inxhinieri Gjeolog është i nevojshëm për realizimin e studimit gjeologo-inxhinierik të zonës ku do të ndërtohet objekti, duke analizuar përbërjen dhe karakteristikat fiziko-mekanike të tokës, stabilitetin e terrenit. Ky studim është thelbësor për projektimin e themeleve dhe për garantimin e sigurisë strukture të objektit

1 (një) Inxhinier Mekanik: Sistemi i ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit (HVAC). Kujdes: Për qendrat shëndetësore kërkohet ventilim i dedikuar me filtra specifike (HEPA nëse ka salla ndërhyrje ose dhoma izolimi) për të parandaluar infeksionet spitalore.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Specialist i Kostove dhe Preventivues)
- 1 (një) Teknik Topograf

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diplomë/certifikatë trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar/certifikuar shqiptar ose i huaj.

Shënim: Kriteri do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyres së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen.

Kriteri për stafin ndihmes, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për stafin ndihmes në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e projektimemeve Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit ndihmes është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje per periudhen 3 (tre) muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Specialist i Kostove dhe Preventivues): Ky specialist është i nevojshëm për përgatitjen e preventivit të punimeve dhe për përlllogaritjen e kostove të ndërtimit në përputhje me projektin e zbatimit. Ai siguron që projekti të shoqërohet me vlerësimin ekonomik të saktë të punimeve dhe me përlllogaritjen e sasive të materialeve dhe punimeve.

1 (një) Teknik Topograf: Tekniku topograf asiston në realizimin e matjeve në terren dhe në përpunimin e të dhënave topografike që shërbejnë për hartimin e projektit. Prania e tij është e nevojshme për të mbështetur procesin e rëlvimeve dhe për të garantuar saktësinë e të dhënave gjeodezike.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **9 (nëntë) punonjës** në listëpagesën e muajit fundit të deklaruar, të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen e fundit të deklaruar.

Shënim: Kriteri do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne shërbimet e kerkuara sipas Termave te References. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mësipër perkon me stafin qe pritet te jete i angazhuar ne keto procedura.

Në lidhje me kriterin për disponimin e të paktën 9 (nëntë) punonjësve, Autoriteti Kontraktor sqaron se kjo kërkesë është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e objektit të

prokurimit “Hartim projekt zbatimi”, i cili kërkon përfshirjen e disa disiplinave të ndryshme inxhinierike.

Hartimi i projektit të zbatimit për një urë përfshin disa faza teknike, si: realizimin e rlevimeve topografike, studimin gjeologo-inxhinierik dhe hidrogeologjik, analizat hidrologjike dhe hidraulike, projektimin strukturor të urës, integrimin e saj me infrastrukturën përreth, si dhe përgatitjen e preventivit dhe përlllogaritjen e kostove të ndërtimit.

Për realizimin korrekt të këtyre proceseve teknike është e domosdoshme përfshirja e specialistëve të fushave përkatëse, konkretisht: arkitekt/urbanist, inxhinier ndërtimi (konstruktor), inxhinier hidroteknik, inxhinier gjeodet/topograf, inxhinier gjeolog/hidrogeolog, inxhinier ndërtimi specialist i kostove dhe një teknik topograf, të cilët së bashku përbëjnë një grup pune minimal të nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit.

Për këtë arsye, kërkesa për një staf minimal prej 9 punonjësish nuk është kufizuese, por është vendosur në funksion të garantimit të cilësisë së projektimit dhe realizimit të plotë të të gjitha studimeve dhe analizave teknike që kërkon një projekt i tillë.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat të përshtatshme **ose ekuivalentet e tyre** për objektin e prokurimit si më poshtë:

- a) **ISO 9001: 2015**, “Për menaxhimin e cilësisë”;
- b) **ISO 14001:2015/ 14001:2026** mbi “Për Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalentin e e saj;
- c) **ISO 45001: 2018**, Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë;

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit, shëndetit, sigurisë në punë, janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e

kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 1(një) Pajisje GPS

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qiraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronësisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

- 1(një) Pajisje Total Station

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qiraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronësisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

- 1(një) Automjet

Për automjetin kur është në pronësi të paraqitet çertifikata e pronësisë, siguracioni, çertifikata e kontrollit teknik. Për automjetin me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë, siguracioni i automjetit, çertifikata e kontrollit teknik.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 10 ku të deklarohet disponimi i mjeteve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e mesipërme janë vendosur në përputhje me natyrën e objektit.

Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet topografike e asete të tjera fizike, aftësitë organizative etj. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

SHËNIM:

- Operatori ekonomik ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jetë brenda kufijve të vleres minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike, për objektin e prokurimit, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar).

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin **nr. 6819/1, datë 22.06.2026** të Titullari të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe referuar nevojave specifike të vetë AK për objektin e prokurimit.

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit është i referohet Seksionit III- Veprat Inxhinierike sipas Manualit të tarifave të përcaktuara sipas VKM-së nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mikqyrje dhe kolaudim" duke u mbajtur në konsideratë vlerat minimale dhe maksimale të lejuara sipas manualit të tarifave në këtë VKM, si dhe Manuali i tarifave të përcaktuara sipas V.K.M-së Nr. 216, Datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

NJËSIA E PROKURIMIT: